



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 140 dt. 24.12.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Urat dhe Rrugët e Kalimit (paketa e parë dhe e dytë) në Shqipëri”, si pjesë e projektit të Gazjellësit Trans – Adriatik (TAP) me këtë kondicion:

Ndërhyrja përforcuese, e cila do të realizohet në objektin Ura e Sharovës, Çorovodë, të mos mbulojë konfiguracionin e strukturës mbështetëse ekzistuese të urës, në mënyrë që të evidentohen të gjitha fazat e ndërhyrjes.

2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI